



 LUARASI



UNIVERSITETI
LUARASI

UDHËRRËFYESI
I STUDIMIT
2023-2024

Tradita jonë, suksesi juaj.



ARASI



Vizioni


Vizioni i Universitetit “Luarasi” është krijimi i një universiteti model ekselence, lider në zhvillimin e qëndrueshëm të dijes në Shqipëri e rajon. Ky vizion synon ta shndërrojë këtë institucion në vatër të kultivimit të vlerave më të mira në funksion të formimit të elitës së profesionistëve të së ardhmes.

Misioni

Misioni i Universitetit “Luarasi” është të krijojë dhe të zhvillojë dije të qëndrueshme përmes mësimdhënies e mësimnxënies cilësore, integritit me praktikën, nxitjes së kurajos dhe kërkimit shkencor për formimin e profesionistëve elitarë e me etikë të lartë profesionale. Vetëm kështu të diplomuarit tanë mund të jenë konkurrues të denjë në tregun e punës.

Universiteti Luarasi ka marrë përsipër t’u ofrojë studentëve dhe shoqërisë një qendër edukimi që integron plotësisht tre drejtimet bazë të procesit akademik: mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe përgjegjësinë sociale. Këto përgjegjësi janë në përputhje të plotë si me prioritetet e zhvillimit të vendit ashtu edhe me sfidat globale të shekullit që po jetojmë. Vetëm kështu mund të kontribuojmë denjësisht, si në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë shqiptare ashtu edhe në rritjen e standardeve të demokracisë në vend.

**“Ne vlerësojmë traditën,
kuptojmë të tashmen,
përgatisim të ardhmen!”**





Universiteti “Luarasi” është institucion jopublik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë i liçensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.611, datë:11.09.2003: “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike LUARASI”. Mbi bazën e këtij akti, institucioni ka nisur veprimtarinë e mësimdhënies, në vitin akademik 2003–2004.

Sot Universiteti Luarasi ka 4 fakultete: atë të Drejtësisë, Ekonomikut, Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit dhe Shkencave Mjekësore.

Po ashtu pranë këtij universiteti funksionon edhe Akademia e Sigurisë Kibernetike.

Universiteti Luarasi është akredituar maksimalisht për gjashtë vite, duke u renditur një ndër katër shkollat e larta më të mira të vendit. Ky certifikim është dëshmia më e mirë për cilësinë dhe besueshmërinë e lartë të diplomave të lëshuara në fund të shkollimit të studentëve. Presim që për vitin akademik 2022–2023 të hapet cikli i tretë i studimeve.

Nuk ka si të jetë ndryshe për sa kohë studentët e drejtësisë të këtij universiteti janë të vetmit ndër të gjitha shkollat e larta jopublike që plotësojnë kriteret për t’u pranuar në shkollën e lartë të magistraturës, e për më tepër gati 80% e të diplomuarve në Drejtësi, Ekonomik, Teknologji Informacioni dhe Inovacioni fillojnë punë gjatë një periudhe kohore prej gjashtë muajsh pas mbarimit të studimeve.

Universiteti Luarasi, ndodhet në një nga zonat më të preferuara universitare të kryeqytetit. Ai ka një infrastrukturë të shkëlqyer, dhe ofron kushtet nga më të mirat për mbarëvajtjen e mësimin dhe argëtimin e studentëve. Pranë këtij Universiteti është angazhuar në mësimdhënie një staf akademik i përkushtuar dhe me profesionalizëm të lartë.

Një sërë marrëveshesh të nënshkruara mes Universitetit Luarasi dhe shumë agjensive vendase dhe universiteteve të huaja i kanë shndërruar auditoret tona në hapsira debati konstruktiv për problemet që lidhen me formimin teorik e praktik të studentëve. Klinika Ligjore e Universitetit Luarasi, si dhe Laboratori i Kriminalistikës janë histori suksesi ku studentët dhe juristët tanë këshillojnë falas dhe aktivizohen për zgjidhjen e shumë çështjeve ligjore në favor të qytetarëve në nevojë.

Numri i studentëve pranë këtij institucioni vetëm për vitin akademik 2021–2022 u rrit me 26%. Interesat e studentëve për një shkollim sa më të mirë mbeten prioritarë për Universitetin Luarasi. Ata marrin pjesë aktivisht në vendimmarrjet e këtij institucioni dhe përfitojnë nga përvojat e universiteteve të huaja në kuadrin e programit Erasmus+. Qeveria Studentore është tepër aktive dhe ndërmerr aktivitete me interes shoqëror dhe publik.

Cilësia e lartë e mësimdhënies, veprimtaria e institucionit e mbështetur fortësisht te ligji, vlera e diplomave për punësim, jeta aktive studentore, lidhja e formimit teorik me veprimtarinë e gjallë praktike, kushtet e shkëlqyera të infrastrukturës etj, janë një ofertë e hapur për maturantët që duan diploma të merituar në fushën e Drejtësisë, Ekonomikut, Teknologjive të Informacionit dhe Inovacionit, Shkencave Mjekësore.

Universiteti Luarasi është pjesë e Grupit Hysenbelliu. Ky grup përfshin një sërë kompanish që operojnë në fusha të ndryshme, ku do të veçoja kompanitë mediatike si Gazeta Panorama, Gazeta Shqiptare, Panorama Sport, Revistën Psikologjia, Televizionin NEWS24, Radio RASH, dhe portalin BalkanWeb.com. I gjithë ky potencial mediatik është vazhdimisht në shërbim të studentëve për të afirmuar personalitetin e tyre edhe në rrafshin publik.

Luarasi është Universiteti juaj. Ai ju mirëpret dhe ju siguron që në fund të studimeve t’ju pajisë me një nga diplomat që ka besueshmërinë më të lartë në vend.


Ju mirëpresim në shtator në auditoret e këtij Universiteti!

Prof. Dr. Ethem RUKA
Rektor i Universitetit Luarasi


PSE LUARASIN?

- ◆ Sepse Universiteti Luarasi është vlerësuar **e akredituar maksimalisht për 6 vite** nga Agjencia Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e lartë të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me agjencinë prestigjioze britanike Quality Assurance Agency në fushën e arsimit të lartë.
- ◆ Sepse kampusi i Universitetit Luarasi **ka një infrastrukturë të shkëlqyer**, e cila ofron mundësitë më të mira për mësimdhënien, praktikat mësimore, shfrytëzimin e burimeve të literaturës, shërbimin e internetit Wi-Fi, bar-lounge, mjediset çlodhëse, parkimin, etj.
- ◆ Sepse mbi **80% e studentëve punësohen** direkt gjashtë muaj mbas mbarimit të shkollimit. Ky standart është arritur falë partneritetit të Luarasit me institucionet e ndryshme publike e private, vendase e të huaja, si dhe besueshmërisë së lartë të diplomave të lëshuara nga ky institucion arsimor.
- ◆ Sepse **besueshmëria publike** për Universiteti Luarasi është shumë e lartë.
- ◆ Sepse **numri i studentëve** ndër vite **ka ardhur duke u rritur**. Vetëm në vitin akademik 2021-2022 numri i studentëve në vitin e parë bachelor, në raport me një vit më parë, u rrit 26%, ndërsa numri përgjithshëm i studentëve, duke përfshirë edhe ciklin e dytë të studimeve master u rrit 23%.

***Ecuria e numrit të studentëve të Luarasit ndër vite**



80%

Studentë me notë
mesatare mbi tetë

Sepse **80% e studentëve** të pranuar në vitin e parë të këtij viti akademik kishin **notë mesatare** të shkollës së mesme **mbi 8 (tetë)**.

Sepse stafi akademik i përbërë nga **më shumë se 190 pedagogë** përbën një garanci më tepër për qëndrueshmërinë e burimeve njerëzore në shërbim të përgatitjes sa më të mirë të studentëve tanë.

Sepse një numër jo i vogël i të diplomuarve tanë **vazhdojnë studimet doktorale** në universitetet prestigjize të huaja.

Sepse Universiteti Luarasi **ofron bursa studimi për studentë ekselentë**, ose me kontribute të spikatura në fushën e artit, sportit, lidërshiptit si dhe për kategori sociale në nevojë.

Sepse Universiteti "Luarasi" është universiteti i juaj. Këtë vit akademik ai **u përzgjodh nga maturantë të 152 shkollave** të mesme të vendit.

Sepse **në zemër të filozofisë sonë** qëndron liria akademike, solidariteti, kreativiteti, inovacioni si dhe forca për t'u përballur me sfidat e shumta të shekullit të XXI-të.



REPUBLIKA E ALBANI
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSIS

Certifikatë

Institucioni i Arsimit të Lartë,
akreditohet në nivel institucional me

nr. 115, datë 1

Akredimi është i vlefshëm

Kjo certifikatë është e vlefshme vetëm

Kryetari i BA

Arjan Gjonça

Nr. i serisë AL032





E SHQIPËRISË
CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Akreditimi

Kolegji Universitar "Luarasi"

Vendim të Bordit të Akreditimit


5 / 12 / 2017 .

deri më 14 / 12 / 2023 .

e shoqëruar me Vendimin e B.A.



Drejtori ASCAL


Dhurata Bozo

Nr. regjistër 32 , datë 20 / 12 / 2017

Stafi Drejtues i Universitetit Luarasi

Universiteti Luarasi është pjesë e Grupit Hysenbelliu.

Stafi drejtues i Universitetit Luarasi është i përbërë nga më shumë se 190 punonjës akademikë me mbështetje nga më shumë se 40 punonjës ndihmës akademikë. Në këtë ekip përfshihen shumë Profesorë, Asistentë Profesorë e Doktorë Shkencash nga më të shquarit në fushat e drejtësisë, ekonomisë, IT-së dhe shkencave mjekësore.

Presidentja e Universitetit Luarasi është Znj. Fabiola Hysenbelliu, e cila ka përfunduar një Master në Politikë dhe Qeverisja në Bashkimin Europian, pranë London School of Economics dhe është gjithashtu Zv. Presidente e Hysenbelliu Group.

Kryetar i Bordit të Administrimit është Ambasador Dashnor Dervishi.

Raktori i Universitetit Luarasi është Prof. Dr. Ethem Ruka, personalitet me një karrierë të gjatë akademike e kërkimore, ish-Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ish-Ministër i Arsimit dhe Shkencës, dy herë Ministër i Mjedisit, Ministër i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe autor i mjaft botimeve universitare e parauniversitare.

Zv. Raktori i Universitetit Luarasi është Prof. As. Dr. Anni Dasho, një personalitet i shquar si në jetën akademike ashtu edhe në fushën e teknologjive të informacionit dhe inovacionit.



Znj. Fabiola Hysenbelliu
PRESIDENTE



Prof. Dr. Ethem Ruka
REKTOR



Prof. Asoc. Dr. Anni Dasho
ZV. REKTOR
DEKAN

*Fakulteti i Teknologjisë
së Informacionit
dhe Inovacionit*



Prof. Dr.
Maksim Haxhia
DEKAN
Fakulteti i Drejtësisë



Prof. Dr. Petrit Bara
DEKAN
*Fakulteti i Shkencave
Mjekësore*



Prof. Asoc. Dr.
Indrit Baholli
DEKAN
Fakulteti Ekonomik

Fakulteti i Drejtësisë

12



UDHËRREFYESI I STUDIMIT 2023-2024

Fakulteti i Drejtësisë ofron Programin e integruar të studimeve në “Drejtësi” si dhe programe Master i Shkencave dhe Master Profesional. Kurrikulat tona akademike janë inovative dhe ofrojnë një formim juridik të thelluar në fushën e së drejtës duke i përgatitur dhe kualifikuar studentët për të ardhmen e një shoqërie europiane, të denjë për t’u përballur me sfida.

Fakulteti i Drejtësisë, me një traditë të konsoliduar, ka konfirmuar cilësinë e studimeve duke u kthyer tërësisht në shërbim të misionit të tij publik – përgatitjes së studentit, specialistit e qytetarit aktiv në një shoqëri demokratike.

Në ftojmë të rinjtë që aspirojnë të jenë juristët e së ardhmes të bëhen pjesë e përpjekjeve tona në formësimin e profesionistëve ekspertë që t’i përshtaten sa më mirë tregut të punës.

Gjenerimi i ideve që i japin zgjidhje sfidave aktuale me të cilat përballlet shoqëria shqiptare, është dhe mbetet sfida jonë e përbashkët.

Studentët e diplomuar pranë Fakultetit të Drejtësisë mbeten të parapëlqyer për t’u punësuar në organet e sistemit të drejtësisë, si dhe në institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Ata, janë të vetmit që kanë mundur të fitojnë dhe përfundojnë denjësisht studimet në Shkollën e Magjistraturës.



Prof. Dr. Maksim Haxhia
Dekan i Fakultetit të Drejtësisë



Dr. Admir Belishta
Zv. Dekan i Fakultetit të Drejtësisë



Dr. Blerina Shkurti
Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Private



Dr. Lorenc Stojani
Përgjegjës i Departamentit të së Drejtës Penale



Prof. Asoc. Dr. Nejla Peka
Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Publike

Programet e Studimit

Program i studimeve të integruara të ciklit të dytë në "Drejtësi"

Program i studimeve të integruara të ciklit të dytë në 'Drejtësi', ka si objektiv kryesor t'u japë studentëve njohuritë e nevojshme për formimin e tyre si specialistë në fushën e drejtësisë. Në funksion të këtij objekti, ky program studimi synon dhënien e një tërësie njohurish në formimin e përgjithshëm teorik sistematik ashtu dhe metodologjik në fushën e të drejtës dhe institucioneve juridike, duke patur parasysh si dimensionin kombëtar dhe ndërkombëtarë të tyre, me qëllim që studenti të jetë i gatshëm për tregun e punës në respektim të standardeve ligjore dhe profesionale.

Nr.	Viti I	60 ECTS	Semestri
1.	Histori e Institucioneve a. Histori e Institucioneve b. E Drejtë Romake	10	I
2.	Hyrje në Ekonomi	6	I
3.	E Drejtë Publike	8	I+II
4.	Histori e shtetit dhe të drejtës në Shqipëri	8	I+II
5.	E Drejtë Civile	12	I+II
6.	E Drejtë Kushtetuese	10	I+II
7.	Anglishte juridike	6	II

Nr.	Viti II	60 ECTS	Semestri
1.	E Drejtë Financiare	6	I
2.	Filozofi e së Drejtës	6	I
3.	E Drejtë Penale (pjesë e përgjithshme)	12	I+II
4.	E Drejtë Ndërkombëtare Publike	10	I+II
5.	E Drejtë Administrative a. E Drejtë Administrative I b. E Drejtë Administrative II	12	I+II
6.	Metodat e Kërkimit Shkencor	4	II
7.	Lëndë me zgjedhje I	4	I
8.	Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut	6	II

Nr.	Viti III	60 ECTS	Semestri
1.	E Drejtë e Detyrimeve	12	I+II
2.	E Drejtë Penale (pj e posaçme)	12	I+II
3.	Procedurë Civile	12	I+II
4.	E Drejtë e Punës dhe e Sigurimeve Shoqërore	10	I+II
5.	E Drejtë Familjare	8	I+II
6.	E Drejtë e Sigurimeve	6	II

Nr.	Viti IV	60 ECTS	Semestri
1.	Drejtësia penale për të mitur	6	I
2.	E Drejtë Ndërkombëtare Private	10	I+II
3.	Procedurë Penale	12	I+II
4.	E Drejtë Europiane a. E Drejtë Publike Europiane b. E Drejtë Private Europiane	12	I+II
5.	E Drejtë Tregtare	10	I+II
6.	Kriminallogji - Penallogji a. Ekzekutimi i vendimeve penale b. Kriminallogji-Penallogji	10	I+II

Nr.	Viti V	60 ECTS	Semestri
1.	E Drejtë Penale Ndërkombëtare dhe Europiane a. E Drejtë Penale Ndërkombëtare b. E Drejtë dhe Politikë Penale Europiane	8	I
2.	E Drejtë Biznesi	6	I
3.	E Drejtë e Pronësisë Intelektuale	4	I
4.	Teknikë Legjislative	4	I
5.	Metoda praktike të zbulimit të veprave penale a. Kriminalistikë b. E Drejtë Penale informatike (kibernetike)	6	II
6.	Lëndë me zgjedhje II	4	II
7.	Lëndë me zgjedhje III	4	II
8.	Praktikë/Klinikë e ligjit	12	I + II
9.	Diplomë/Provim përfundimtar	12	II

MA/

Cikli i dytë i studimeve Master

1 Master i shkencave/E Drejtë Civile dhe Tregtare

Masteri i Shkencave në “E drejtë civile dhe tregtare” është një ndërthurje e së drejtës private shqiptare me atë ndërkombëtare. Ky master plotëson nevojën në rritje për formim shkencor të thelluar me qëllim aftësimin e studentit për një kërkim të parvarur shkencor në fushën e studimeve të së drejtës civile.

Ky program studimi përfshin:

Nr.	Viti i parë	60 ECTS	Semestri
1.	Njohja, Ekzekutimi i Vendimeve të Huaja dhe Përmbartimi Gjyqësor	8	I
2.	Metodat e Kërkimit Shkencor	8	I
3.	Çështje të Drejtësisë Kushtetuese – Zhvillime Bashkëkohore	6	I
4.	Të Drejtat Reale dhe Trashëgimia	10	II
5.	Antropologjia e Ligjit	6	I
6.	E Drejta Detyrimeve – Studime të Thelluara	8	II
7.	Zhvillimet Aktuale në të Drejtën Europiane	6	II
8.	Arbitrazhi Ndërkombëtar	8	II

Nr.	Viti i dytë	60 ECTS	Semestri
1.	Të Drejtat e Njeriut dhe Jurisprudenca e GJEDNJ-së në Fushën Civile	8	I
2.	E Drejtë Biznesi	10	I
3.	E Drejta e Krahastuar e Punës dhe e Sigurimeve në Komunitetin Europian/ E Drejta Bankare/ Sistemet Tatimore	6	I
4.	E Drejtë Falimentit/ E Drejtë Gjyqësore	6	I
5.	Përvoja Praktike	12	II
6.	Tema e Diplomës	18	II

2 Master i shkencave/ E Drejtë Penale

Masteri është i fokusuar në një trajtim të avancuar të së drejtës penale dhe të shkencave penale, duke trajtuar probleme të rëndësishme si e drejta penale shqiptare dhe këndvështrimi i saj në kuadër të së drejtës penale europiane dhe ndërkombëtare, mbrojtja europiane dhe ndërkombëtare e të drejtave të njeriut në aspektin e luftës kundër veprave të ndryshme penale.

Ky program studimi përfshin:

Nr.	Viti i parë	60 ECTS	Semestri
1.	E Drejta Penale – Studime të thelluara	8	I
2.	Çështje të Drejtësisë Kushtetuese – Zhvillime Bashkëkohore	6	I
3.	Metodat e Kërkimit në Shkencat Juridike	8	I
4.	Mjekësi Ligjore	6	I
5.	Kriminalogji-Penallogji	8	I
6.	Zhvillimet Aktuale në të Drejtën Europiane	6	II
7.	Kriminalistikë	10	II
8.	E Drejtë Penale Procedurale e Krahastuar	8	II

Nr.	Viti i dytë	60 ECTS	Semestri
1.	Të Drejtat e Njeriut dhe Jurisprudenca GJEDNJ-së në Fushën Penale	8	I
2.	E Drejta Ndërkombëtare Penale	10	I
3.	E Drejtë Penale për të Miturit / Mjekësi ligjore / Veprat Penale në Fushën e Ekonomisë	6	I
4.	Veprat Penale në Fushën e Kibernetikës dhe Privatësisë/ Caktimi i Dënimeve dhe Dënimet Alternative/ E Drejta Gjyqësore	6	I
5.	Përvoja Praktike	12	II
6.	Tema e Diplomës	18	II

Programi i studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në "Siguria dhe Rendi Publik" u drejtohet të gjithë kategorisë së studentëve që kanë mbaruar një bachelor jo vetëm në Drejtësi dhe ka për qëllim të pajisë të gjithë të diplomuarit me njohuri të thelluara dhe ekspertizë profesionale në fushën e Sigurisë dhe Rendit Publik. Ky program kaq specifik është i vetmi që ofrohet nga institucionet e arsimit të lartë dhe shumë i kërkuar në tregun e punës dhe për këtë arsye të gjithë të diplomuarit janë të punësuar.

Ky program studimi përfshin:

Nr.	Viti i parë	60 ECTS	Semestri
1.	Metodat e Kërkimit Shkencor	5	I
2.	Policia Gjyqësore si Subjekt i Procedimit Penal	3	I
3.	Sistemi i Sigurisë Kombëtare	4	I
4.	Sistemet e Sigurisë Ndërkombëtare	4	I
5.	Policimi dhe Çështjet e Sigurisë	3	I
6.	Dinamika dhe Kërcënimet e Krimit Bashkëkohor	4	I
7.	Menaxhimi dhe Liderhipi në Strukturat e Sigurisë e të Rendit	4	II
8.	Policimi dhe Inteligjenca	4	II
9.	Institucionet Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Policor	4	II
10.	Kriminologji dhe Viktimologji	4	II
11.	E Drejtë Penale Ndërkombëtare	5	II
12.	Mbikëqyrja dhe Kontrolli i Sektorit të Sigurisë	4	II
13.	Praktikë Profesionale	6	II
14.	Provim/Tema e Diplomës	6	II

Laboratori i Kriminalistikës *në Fakultetin e Drejtësisë*

Laboratori i Kriminalistikës transmeton njohuri të plota lidhur me kërkimin, fiksimin, dokumentimin, administrimin dhe ruajtjen e provave në vendin e ngjarjes. Ky laborator drejtohet nga titullari i lëndëve të Kriminalistikës dhe Viktimologji-Penalogjisë Prof. Asoc. Dr. Luan Velqoti dhe shërben për kryerjen e praktikës dhe orëve të seminareve të këtyre disiplinave.



Klinika Ligjore “LUARASI”

Klinika Ligjore “Luarasi” është njësi akademike e Fakultetit të Drejtësisë e përbërë nga studentët e këtij fakulteti të mbikqyrur nga pedagogët e tyre. Qëllimi i Klinikës Ligjore “Luarasi”, është që të ofrojë ndihmë juridike falas për personat në pamundësi ekonomike. Universiteti “Luarasi” është krenar për ngritjen e Klinikës Ligjore “Luarasi” si një mundësi e shkëlqyer për studentët që të zhvillojnë aftësitë e tyre praktike dhe përvojë pune me klientë të vërtetë në një mjedis të ngjashëm me atë të zyrave ligjore.



Konkurs Ndërkombëtar

Studentët e Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit “Luarasi” dhe profesor Admir Belishta u kualifikuan si fitues në fazën finale të konkursit “Moot Court Albania - VIII” organizuar nga Qendra Europiane në bashkëpunim me Civil Right Defenders (CRD). Luarasi”, me studentët e Drejtësisë, do të përfaqësojë Shqipërinë në konkursin rajonal me universitete të Evropës Juglindore.





www.luarasi-univ.edu.al



Fakulteti Ekonomik

Fakulteti Ekonomik ka hapur dyert në vitin 2013. Qysh atëherë ai është rritur dhe ka diplomuar me sukses breza të tërë studentësh, të cilët sot punojnë si në sektorin publik ashtu edhe atë privat. Diplomat e lëshuara nga ky fakultet gëzojnë besueshmëri të lartë në tregun e punës si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Një pjesë e të diplomuarve tanë kanë patur fatin të vazhdojnë studime pasuniversitare në shumë universitete prestigjioze të botës.

Pranë këtij fakulteti punon një trupë akademike që dallohet për profesionalizëm të lartë dhe përvojë të spikatur akademike. Fakulteti Ekonomik ofron mundësi studimi në programet Bachelor në fushën e Administrimit dhe Financës. Po ashtu, ai ofron programe studimi edhe në gjashtë Mastera Profesionale e Shkencorë. Së shpejti pranë Luarasi do të hapet edhe cikli i tretë i studimeve, i cili do të ofrojë mundësi për njohuri edhe më të thellura në fushën e ekonomisë. Fakulteti i Ekonomisë



është një oportunitet i shkëlqyer për të gjithë ata që duan të diplomohen në sektorët e financës dhe administrimit të biznesit. Prurjet e viteve të fundit pranë këtij fakulteti tregojnë interesin e lartë që kanë shpalosur maturantët shqiptarë për të ndjekur studimet në këto fusha.

Prof. Asoc. Dr. Indrit Baholli
Dekan i Fakultetit Ekonomik



Prof. Asoc. Dr. Leontiev Çuçi
Përgjegjës i Departamentit të Ekonomiksit



Dr. Aelita Mani
Përgjegjëse e Departamentit të Administrim Biznesit



Dr. Zhaklina Dhamo
Përgjegjëse e Departamentit të Financë Bankë

Programet e Studimit

1 Bachelor BA/Administrim Biznes

Ky program studimi përgatit specialistë të mirë-filltë për administrimin e bizneseve të fushave të ndryshme të ekonomisë. Të diplomuarit e këtij profili zotërojnë një gamë të gjerë njohurish për gjithë problematikat e menaxhimit të bizneseve të vogla, të mesme e të mëdha si dhe për drejtimin e sukseshëm të tyre. *Ky program studimi përfshin:*

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Mikroekonomi	6
2.	Matematikë I	6
3.	Shkrim akademik	6
4.	Bazat e Kontabilitetit	6
5.	Anglisht	6
6.	Sociologji	6
7.	Makroekonomi	6
8.	Histori e Mendimit Ekonomik	6
9.	Hyrje në Administrim Biznesi	6
10.	Matematikë II	6

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Bazat e Marketingut	6
2.	Financë Publike	6
3.	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	6
4.	Politikat Ekonomike në BE	5
5.	Bazat e së Drejtës	6
6.	Statistikë Biznesi	4
7.	Informatikë	6
8.	Kontabiliteti i Kostos dhe Drejtimit	6
9.	Menaxhimi i SME	6
10.	Investime	4
11.	Kontabilitet Financiar	4

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Strategji Biznesi	6
2.	Tregje Financiare	6
3.	Menaxhim i Inovacioneve	6
4.	Sjellje Organizative	6
5.	Politikat Financiare dhe Monetare	6
6.	Menaxhimi i Operacioneve	6
7.	Biznes Ndërkombëtar	6
8.	Psikologji Marketingu / E drejta Administrative	5
9.	Praktikë Profesionale	3
10.	Seminar Special mbi Ekonominë Shqiptare dhe Botërore	4
11.	Punimi i Diplomës	6

2 Bachelor BA/Financë - Bankë

Ky program synon të përgatisë ekonomistë të specializuar në fushat e financës dhe kontabilitetit. Ai ka për qëllim të përgatisë studentët me nocionet bazë të auditimit, si dhe të funksionimit të kompanive të sigurimeve. Bota e financës, sidomos në vendin tonë pritet të ketë një zhvillim të vullshëm në vitet e ardhshme. *Ky program studimi përfshin:*

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Mikroekonomi	6
2.	Matematikë I	6
3.	Shkrim akademik	6
4.	Bazat e Kontabilitetit	6
5.	Anglisht	6
6.	Sociologji	6
7.	Makroekonomi	6
8.	Histori e Mendimit Ekonomik	6
9.	Hyrje në Administrim Biznesi	6
10.	Matematikë II	6

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Kontabilitet Financiar	6
2.	Financë Publike	6
3.	Bazat e së Drejtës	6
4.	Menaxhim Strategjik	6
5.	Drejtim Marketingu	5
6.	Statistikë Biznesi	4
7.	Informatikë	6
8.	Paraja dhe Bankat	6
9.	Menaxhimi i Operacioneve	5
10.	Investime	4
11.	Kontabilitet Kosto	6

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Drejtim Portofoli	6
2.	Tregje dhe Institucionet Financiare	6
3.	Menaxhim Risku	6
4.	E drejta Financiare dhe Bankare	6
5.	Drejtim Bankar	5
6.	Kontabilitet Drejtimi	6
7.	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit	6
8.	Analizë Raportesh Financiare/ Mbikëqyrja Bankare	5
9.	Praktikë Profesionale	3
10.	Drejtim Financiar	5
11.	Punimi i Diplomës	6

MA/ Master

Cikli i dytë i studimeve

1

Master i shkencave/Banka dhe Tregjet Financiare

Të diplomuarit në këtë Master Shkencor zotërojnë gjithë potencialin e njohurive për të punuar me efikasitet e profesionalizëm në kompanitë më të mira financiare si Bankat, Shoqëritë e Sigurimeve, Fondet e Investimit, Kompanitë e Mikrokrede dhe Kredive Konsumatore, Kompanitë e Auditimit dhe Kontabilitetit etj.

Ky program studimi përfshin:

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Mikroekonomi e Avancuar	7
2.	Tregu Bankar dhe Bankingu	6
3.	Bankat dhe Drejtimi Bankar	6
4.	Kontabilitet Nacional	7
5.	Institucionet Financiare dhe Tregjet e Kapitaleve	7
6.	Ekonometri e Aplikuar	6
7.	Makroekonomi e Avancuar	7
8.	Standardet Ndërkombëtare Bankare dhe Financiare	7
9.	Investime dhe Menaxhim Portofoli	7

Nr.	Viti i dytë	60 ECTS
1.	Menaxhim Risku Financiar / Menaxhim Risku në Sigurime	6
2.	Metodologjia e Kërkimit	8
3.	Auditi Financiar Bankar	8
4.	Strategjia Financiare dhe e Korporatave	8
5.	Përvoja Praktike	12
6.	Tema e Diplomës	18

2

Master i shkencave/Menaxhim Ekzekutiv

Programi i studimit të këtij masteri synon t'i pajisë studentët me njohuritë më bashkëkohore për drejtimin e kompanive të mesme e të mëdha, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Analiza e proceseve të shërbimeve dhe prodhimit, si dhe leximi i mirë i bilanceve, janë vetëm disa nga aftësitë që do të transmentohen përmes këtij masteri.

Ky program studimi përfshin:

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Ekonomiksi i Punës	7
2.	Ekonomiks Menaxherial	6
3.	Menaxhim Strategjik	6
4.	Drejtim Financiar	7
5.	Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Karrierës	7
6.	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit	7
7.	Menaxhimi i Ndryshimit dhe Rritjes	6
8.	Menaxhimi i Projekteve	7
9.	Qeverisja e Korporateve/Aftësi Menaxheriale	7

Nr.	Viti i dytë	60 ECTS
1.	Politikat e Zhvillimit	8
2.	Metodologjia e Kërkimit	8
3.	E drejtë Biznesi/Leadership	6
4.	Menaxhim Marketingu	8
5.	Përvoja Praktike	12
6.	Tema e Diplomës	18

3

Master i profesional /Financë dhe Menaxhim Risku

Ky master profesional synon të japë thelbin e dijes dhe praktikës për të lidhur në mënyrë sa më të shpejtë studentin me botën e punës. Menaxhimi i riskut financiar është kompetencë e domosdoshme për të mos lejuar shpërthimin e krizave financiare brenda kompanive dhe bizneseve.

Ky program studimi përfshin:

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Menaxhim Risku Financiar	6
2.	Banking	5
3.	Metodologji e Kërkimit në Financë	5
4.	Kontabilitet Nacional	5
5.	Institucionet Financiare dhe Tregjet e Kapitaleve	6
6.	Ekonometri e Aplikuar	5
7.	Analiza dhe Raporte Financiare	5
8.	Strategji e Korporatave Financiare/ Strategji Financiare (Raste Studimore)	5
9.	Praktikë Profesionale	6
10.	Provim/Tema e Diplomës	12

4

Master i profesional /Marketing dhe Reklama

Në Shqipëri ka dhjetra televizione, radio, gazeta, portale dhe blogje, të cilat jetojnë me të ardhurat e siguruar nga finacimi i reklameve dhe promocioneve të bizneseve të ndryshme. Masteri Marketing dhe Reklama përgatit specialistë që shërbejnë si një urë lidhëse mes biznesit dhe medias. Të diplomuarit në këtë master janë arkitektët e suksesit të produkteve apo shërbimeve të sponsorizuara.

Ky program studimi përfshin:

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Menaxhim Bashkëkohor i Marketingut	6
2.	Menaxhim i Reklamës dhe Komunikimi në Marketing	5
3.	Sjellje Konsumatore	5
4.	Menaxhimi i PR dhe Marketing Korporatash	5
5.	Metodologjia e Kërkimit në Marketing	6
6.	Marketingu dhe Inovacioni	5
7.	Menaxhimi i Cilësisë dhe Standardeve	5
8.	Psikologji Marketingu/Etika e Biznesit	5
9.	Praktikë Profesionale	6
10.	Provim/Tema e Diplomës	12



Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit

22



UDHËRREFYESI I STUDIMIT 2023-2024

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ofron programe studimi në të dy ciklet: Bachelor dhe Master. Programet e këtij fakulteti janë nga më të parapëlqyerat prej gjeneratës së re, sepse teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit kanë ndikuar dhe po ndikojnë fuqimisht në globalizmin e kulturës dhe komunikimit, kujdesin shëndetësor, shërbimet publike, aktivitetet kulturore, veprimtarinë qeverisëse, biznesin, edukimin në distancë, sistemin bankar, aeronautikën, aviacionin, mbrojtjen, shërbimet inteligjente, kërkimin shkencor, rrjetet sociale, postën elektronike, tregëtinë online, telefoninë celulare, teknologjitë audiovizive etj.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit ofron programe studimi që u japin mundësinë studentëve të formohen me njohuritë e duhura teorike e praktike për të punuar e kontribuar në këto fusha kaq të rëndësishme e



të larmishme. Universiteti Luarasi ofron të gjithë infrastrukturën moderne laboratorike si dhe një staf akademik mjaft të kualifikuar për të marrë përsipër këtë sfidë kaq tërheqëse. Oferta jonë i përgjigjet më së miri kërkesave në rritje të tregut, duke garantuar një shkallë të lartë punësimi, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Prof. Asoc. Dr. Anni Dasho
*Dekan i Fakultetit të Teknologjisë
së Informacionit dhe Inovacionit*



Prof. Dr. Thoma Mitre
*Përgjegjës i Departamentit
të Informatikës Ekonomike*



Dr. Gentian Hoxhalli
*Përgjegjës i Departamentit
të Matematikës dhe Statistikës*



Prof. Dr. Adriana Gjonaj
*Përgjegjëse e Departamentit
të Teknologjisë së Informacionit*

Programet e Studimit

1 Bachelor BA/Informatikë Ekonomike

Ky program studimi synon të pajisë studentët me njohuritë bazë në fushën e informatikës ekonomike. Në përfundim të studimeve të këtij programi, të diplomuarit mund të punësohen në një spektër të gjerë proflesh pune, si analistë biznesi dhe të dhënash, specialist në fushën e informatikës, në tregun e komunikimeve elektronike, në telekomunikacion e media elektronike, si auditues sistemesh informacioni e kompjuterike, etj. *Ky program studimi përfshin:*

Nr.	Viti i parë	60 ECTS
1.	Mikroekonomi	5
2.	Hyrje në Teknologji Informacioni	4
3.	Shkrim Akademik dhe Metoda Kërkimi	5
4.	Algoritmikë dhe Hyrje në Programim C++	6
5.	Menaxhim i Biznesit	5
6.	Hyrje në Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit	5
7.	Makroekonomi	5
8.	Bazat e Kontabilitetit	5
9.	Arkitekturë Kompjuteri	6
10.	Menaxhimi i Inovacioneve	6
11.	Matematikë	14
12.	Anglisht	14

Nr.	Viti i dytë	60 ECTS
1.	Bazat e Financës	5
2.	Bazat e Statistikës	4
3.	Matematikë 2	4
4.	Bazat e Marketingut	5
5.	Strukturë të Dhënash	6
6.	Programim i Orientuar në Objekte-Hyrje në JAVA	6
7.	Drejtim Financiar - Menaxhim i Operacioneve	5
8.	Kontabilitet Financiar	5
9.	Web Design dhe Programim	6
10.	Organizim i Sistemeve Kompjuterike dhe Sistemet e Operimit	5
11.	Histori e Ekonomisë dhe Mendimit Ekonomik	5
12.	Anglisht Biznesi	4

Nr.	Viti i tretë	60 ECTS
1.	Menaxhim i Rrjetave Kompjuterike	6
2.	Hyrje në Teorinë e Bazave të të Dhënave	6
3.	Inteligjencë Biznesi dhe Datamining	6
4.	Dizenjim, Menaxhim, Implementim i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit	6
5.	Hyrje në Inxhinieri Software-ike	6
6.	Statistikë e Biznesit	4
7.	Tregjet Financiare - Menaxhim Marketingu	5
8.	Hyrje në Menaxhim Projektsh	6
9.	Praktikë dhe Zhvillim Karriere	6
10.	Temë diplome / Provim i Përgjithshëm Përfundimtar	9

2 Bachelor BA/ Teknologji Informacioni dhe Inovacioni

